




Pranimi / Dërgimi Prenullimi / Pre-data Prizimi / Dërgimi		18.01.2022 viti god year	
Organ / Rrethi Organ / Jednina Org / Unit	Ko / Prati Pr / Part Prat / No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohësira Quantity
SKIMSHAK	227/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1207/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1207/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga ankuesja

në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.1207/2021 e datës 21.12.2021 e parashtruar nga ankuesja në Prishtinë.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare e Arkivit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MRKS), me datë 21.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6250/2021 të regjistruar me numër A.nr.1207/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shpenzimeve në emër të shujtës për ditët e pranisë në punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë

29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këshilli, me datë 12.01.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6250/2021 të regjistruar me numër A.nr.1207/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 20.12.2021 nga L.B për ankuesen; Vërtetimin e datës 01.06.2021 të lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore i MKRS-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 12.01.2022; Akt Emërimit e datës 02.09.2016 në emër të ankueses; Kërkesë për zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive dhe pagimin e shujtës në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2015 e parashtruar nga ankuesja më datë 01.12.2021 për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Divizionit të Burimeve Njerëzore të MKRS.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 02.09.2016 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare për Arkiv në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. E njëjta, me datë 01.12.2021 ka parashtruar kërkesë të Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe të Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore, lidhur me kompensimin e shpenzimeve në emër të shujtës në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2015, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë. Ndërsa me datë, 20.12.2021 ankuesja është njoftuar përmes e-mailit se kërkesa nuk mund të aprovohet për arsye se nuk ka mjete buxhetore të ndara për këtë kategori.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhet t'i bëjë kompensimin e shpenzimeve të shujtës për ditët e pranisë në punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, siç përcaktohet: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Mirëpo Oda Ekonomike e Kosovës si partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social dhe njëherit nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje pas datës 31.12.2017.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për njohjen e të drejtës për realizimin e shpenzimeve në emër të shujtës nuk ka bazë ligjore sepse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka fuqi juridike pas datës 31.12.2017. Ndërsa pretendimi ankimor për kompensimin e shpenzimeve në emër të shujtës në mënyrë retroaktive nga data 01.01.2015, në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, është parashkruar, kështu që pretendimet ankimore të ankueses mbi këtë bazë ligjore janë të pabazuar.


Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1207/2021

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses.
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS);
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MKRS; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.